

## **Të drejtat e njeriut**

Kuvendi Gjeneral i Kombeve të bashkuara me 10 dhjetor 1948 ka sjell deklaratën mbi të drejtat e njeriut. Pas këtij akti historik, Kuvendi Gjeneral ka ftuar të gjitha shtetet anëtare që të publikojnë tekstin e Deklaratës dhe të ndihmojnë që ai të shpërndahet, tregohet, lexohet shpjegohet posaçërisht në shkolla dhe institucione tjera arsimore në të gjitha shtetet ose territoret pa marr parasysh statusin e tyre politik.

---

## **ASAMBLESA GJENERALE E KOMBEVE TË BASHKUARA shpall**

Këtë DEKLARATË MBI TË DREJTAT E NJERIUT si ideal të përgjithshëm të cilin duhet ta arrijnë të gjithë popujt dhe kombësitë në mënyrë që çdo person dhe organ shoqëror, duhet të kenë gjithmonë parasysh këtë deklaratë, tentojnë që me mësim dhe edukim të kontribuojnë në respektimin e këtyre të drejtave dhe lirive, dhe që me masa të posaçme nacionale dhe ndërkombëtare të sigurohet miratimi i përgjithshëm dhe i vërtetë nga ana e të gjithë faktorëve, postatu edhe nga ana e popujve të atyre territoreve që janë nën udhëheqjen e tyre.

---

## **PASQYRË E SHKURTË E TË DREJTAVE TË NJERIUT**

1. Të gjitha qeniet njerëzore lindin të lirë dhe të barabartë me dinjitet dhe të drejta të barabarta.
2. Të gjithëve u takojnë të gjitha të drejtat dhe liritë e shpallura në këtë Deklaratë pa dallime pikëpamje racore, ngjyre, gjinie, gjuhe, religjioni, pikëpamje politike, apo çfarëdo mendimi tjetër, prejardhje shoqërore ose nacionale, pasurie, lindjes apo rrethanave tjera.
3. Secili ka të drejtë në jetë, liri dhe siguri personale
4. Askush nuk guxon të mbahet në robëri, nënshtrim, robëria dhe tregtia me rob është e ndaluar në çdo formë
5. Askush nuk guxon ti nënshtrohet mundimit apo dënimeve mizore jo njerëzore dhe veprimeve apo dënimeve nënçmuese
6. Çdokush ka të drejtë që çdo kund të jetë i pranuar si subjekt juridik
7. Të gjithë janë të barabartë para ligjit, dhe kanë të drejtë të jenë të mbrojtur para ligjit pa kurrfarë dallimi
8. Çdokush ka të drejtë që gjyqi nacional përkatës ta mbrojë në mënyrë efektive nga thyerja e të drejtave elementare njerëzore të cilat janë të pranuar me kushtetutë dhe ligj.
9. Askush nuk guxon të arrestohet, mbyllet dhe ndiqet penalisht.
10. Çdokush ka të drejtë të barabartë në gjykim të drejtë dhe të hapur para gjyqit të pavarur dhe të paanshëm.
11. Çdokush që është i akuzuar për vepër penale ka të drejtë që të konsiderohet i pafajshëm deri sa në bazë të ligjit mos të vërtetohet e kundërta.
12. Askush nuk guxon ti nënshtrohet ndërhyrjes pa dëshirë në jetën private, familje, banesë, letra, apo me sulme në nderë të njeriut.

13. Çdokush ka të drejtë në lëvizje të lirë dhe të zgjedhje të vendbanimit në kufi të shtetit përkatës.
14. Çdokush ka të drejtë të kërkoj dhe gëzoj të drejtën e vendosjes në shtete të tjera nga ndjekja.
15. Çdokush ka të drejtë në një nënshtetësi. Askush nuk guxon të jetë i privuar nga nënshtetësia apo e drejta të ndërroj nënshtetësi nën ndikimin e tjetërkujt.
16. Çdokush ka të drejtë të kurorëzohet dhe të krijoj familje.
17. Çdokush ka të drejtë të posedoj pronë vet por edhe në bashkësi me të tjerët .
18. Çdokush ka të drejtë në liri mendimi dhe besimi, kjo e drejtë përfshinë lirinë e ndërrimit të besimit apo të paragjykitimit.
19. Çdokush ka të drejtë në liri të mendimit dhe shprehjes që përfshinë të drejtën të mos të jetë i shqetësuar për shkak të mendimit të tij dhe të drejtën të kërkojë, merr dhe përhap informata.
20. Çdokush ka të drejtë të tubimit të lirë dhe shoqërimit.
21. Çdokush ka të drejtë të merr pjesë në udhëheqje të punëve publike të vendit të tij, drejtpërdrejt apo përmes përfaqësuesve të zgjedhur në mënyrë të lirë.
22. Çdokush, si pjesë e shoqërisë ka të drejtë në sigurimin social, dhe të drejtë të realizoj të drejta shoqërore kulturore ekonomike, të drejta të nevojshme për dinjitet dhe liri të zhvillimit të personalitetit të tij.
23. Çdokush ka të drejtë në punë, zgjedhje të lirë të punësimit, në kushte të volitshme dhe përshtatshme të punës, dhe mbrojtje nga papunësia .
24. Çdokush ka të drejtë në pushim dhe kënaqësi, kufizim të logjikshëm të orarit të punës pushim me pagesë të kohë paskohshëm .
25. Çdokush ka të drejtë në standard jetësorë i cili siguron shëndet, mirëqenie, të atij dhe familjes , posaçërisht ushqimi, veshmbathje, banim dhe kujdesie shëndetësorë
26. Çdokush ka të drejtë në shkollim.
27. Çdokush ka të drejtë që lirisht të merr pjesë në jetën kulturore-artistike të bashkësisë, të gëzoj i lirë jetën kulturore-artistike të bashkësisë të gëzoj artin, dhe të merr pjesë në përparimin shkencor dhe në të mirat që vijnë nga ajo.
28. Çdokush ka të drejtë në rregullimin shoqëror dhe ndërkombëtar në të cilin e drejta dhe liritë të shpallura në këtë deklaratë mund të jenë plotësisht të realizuara.
29. Çdokush ka për detyrë të respektoj të drejtat dhe lirinë e të tjerëve me qëllim të përmbushjes së kërkesës morale të rregullimit publik dhe mirëqenies së përgjithshme në shoqërinë demokratike.
30. Askush nuk ka të drejtë të shkatërroj asnjë prej të drejtave dhe lirive të cilat kjo deklaratë i përmban .